

VENDIM
Nr.743, datë 7.11.2008

PËR MOSDHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO ORA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizionë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.709, datë 16.7.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim radiofonik privat analogjik tokësor subjektin “ORA” sh.p.k., pasi në përfundim të vlerësimit me pikë, ky subjekt u rendit në vend të dytë.
2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)